



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.33/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Faton Ademi anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bajram Rexhahmetaj duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, për shkak të vendosjes së njoftimit – materialit propagandues për fushatën zgjedhore në hapësirat publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 05.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), kështu që subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1,200.00 (njëmijë e dyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**

A r s y e t i m

Me datën 02.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Instituti Demokratik i Kosovës(KDI) me të cilën pretendon se me datën 01.06.2017, ka vërejtur se në hyrje të shkollës “Kadri Zeka” të qytetit të Gjilanit, monitoruesit e tyre ka hasur në postierin e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje për një tubim elektorale të vendosur në hapësirat publike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33paragrafi1,pika b),të LPZ-së duke pretenduar se subjekti në fjalë ka shkel këto nene në momentin që ka vendosur posterin në hapësirë publike.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur1(një)fotografin të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 02.06.2017, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, thekson se pretendimet e ankuesit janë të pabazuara dhe të pa argumentuara pasi që parashtruesi i ankesës nuk e ka specifikuar kohën se kur ka ndodhë ngjarja e supozuar, pasi që as nga pretendimi i ankesës dhe as nga provat e parashtruara nga ankuesi nuk mund të vërtetohet koha e shkeljes së supozuar dhe se ankesa për shkak të mungesës së provave të paqarta propozon që të hedhet e palejuar apo si e pasafatshme. Në përgjigje në ankesë theksohet se subjekti politik LVV në pajtim me dispozitat ligjore

të LZP-së i ka informuar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatet e tyre për Kodin e Mirësjelljes së subjekteve politike dhe për zbatimin e tij dhe se subjekti në fjale ka marr të gjitha masat për evitimin e shkeljeve të mundshme nga anëtarët e tij.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se njoftimi – materiali propagandues për fushatën zgjedhore të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje është vendosur në ndertës publike e cilat shfrytëzohen për shërbime publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave”*

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, gjatë vendimmarrjes mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, si dhe faktin se njoftimi – materiali propagandues për fushatën zgjedhore të subjektit politik në fjalë është vendosur në objekt publik gjegjësisht në hyrje të Universitetit Publik Kadri Zeka në Gjiilan.

Paneli e urdhëroi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje, për ta përmirësuar shkeljen e kodit të mirësjelljes për subjektet politike, brenda afatit të caktuar ku i njëjti ka ndërmarr veprimet e duhura për evitimin e shkeljes duke e larguar menjëherë materialin propagandues për fushatën zgjedhore nga vendi ku ka ndodhur shkelja, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara më lartë, Paneli konstaton se nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që materiali propagandues për fushatën zgjedhore të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, është vendosur në objektin e Universitetit Publik Kadri Zeka në

Gjilan i cili shfrytëzohet për shërbime publike të qytetarëve, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit në fjalë që ka ndërmarr për evitim të shkeljes si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë e të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar.

Nga të dhënat e cekura si më lart Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.33/2017 më datën 05.06.2017.

Kryesuesi i Panelit

Zyhdë Haziri



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.